

V E N D I M
Nr.304, datë 30.6.1994

PËR DOKUMENTACIONIN E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE

Në zbatim të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Familjet që pretendojnë për ndihmë ekonomike të plotë ose të pjesshme, për të përfituar këtë ndihmë përsëritin çdo muaj këto dokumente:

- a) kërkesë;
- b) deklaratë për situatën e punësimit të çdo anëtarit të familjes;
- c) deklaratë për të ardhurat e familjes;
- ç) deklaratë për mosndryshimin e situatës ekonomike të familjes së tij.

2. Nga zyrat përkatëse çdo vit a në muajin e parë të pretendimit, ose kur në secilin prej dokumenteve ka ndryshime, merret ky dokumentacion:

- a) certifikatë e gjendjes familjare;
- b) vërtetim nga zyra e kadastrës;
- c) vërtetim nga zyra tatim-taksa;
- ç) vërtetim nga zyra e punës;
- d) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pronave;
- dh) vërtetim nga zyra e regjistrimit të automjeteve;
- e) vërtetim nga zyra e sigurimeve shoqërore.

3. Në rastet kur familja përfituese rikthehet në skemën e ndihmës ekonomike pas një periudhe ndërprerjeje, riplotëson dokumentacionin e plotë.

4. Përgjegjësi i seksionit të ndihmës ekonomike në bashki e komunë, si dhe inspektorati i ndihmës ekonomike do të njoftohet zyrtarisht çdo muaj nga zyrat përkatëse për:

- a) listën e personave që ushtrojnë veprimtari private me leje ushtrimi profesioni, nga zyra e tatim-taksave;
- b) listën e personave që kanë prona, të cilat mund të sigurojnë të ardhura, nga zyra e regjistrimit të pronave;
- c) listën e personave që disponojnë automjete, nga zyra e regjistrimit të automjeteve;
- ç) listën e personave të punësuar, nga zyra e punës;
- d) listën e pensionistëve, nga zyra e sigurimeve shoqërore.

Kjo listë do të përgatitet vetëm një herë dhe në periudhat e ardhme do të raportohet vetëm ndryshimi i saj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi